REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-2287/26 datë: 17.06.2026

Npi – 01/143 datë: 26.06.2026

Bazuar në: Nenin 52 të Ligjit e për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Nenin 5 të Udhëzimi Administrativ të (MPL) Nr.05/2020 Për Procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë; Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më 26.06.2026, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARES SË KPF-së znj.YLLKË FEJZULLAHU ME ANËTARE TË RE

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -V- të rregullt për vitin 2026, të mbajtur më: 26.06.2026, unanimisht miratoi vendimin për zëvendësimin e anëtares së KPF-së znj.Yllkë Fejzullahu me znj.Adelina Shabani.

II

A r s y e t i m: Për shkakë të ndarjes nga jeta të anëtares së Kuvendit të Komunës së Shtimes, njëkohësisht anëtare e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), znj.Yllkë Fejzullahi nga fshati Vojnovc, anëtare e subjektit politikë Lëvizja Vetëvendosje, posti i anëtares në këtë Komitet ka mbetur vakant. Për këtë arsye, propozohet nga subjekti politikë Lëvizja Vetëvendosje emërimi i znj.Adelina Shabani nga fshati Godanc i Poshtëm, anëtare e subjektit politkë Lëvizja Vetëvendosje, si anëtare e Komitetit për Politikë dhe Financa.
Për zëvendësimin e znj.Yllkë Fejzullahi në Komitetin për Politikë dhe Financa (KPF), Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 26.06.2026 unanimisht, mori vendim që të zgjedhë znj.Adelina Shabani, anëtare të Komitetit për Politikë dhe Financa, nga subjekti politikë Lëvizja Vetëvendosje.

III

Vendimi është aprovuar duke marrë parasysh edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, Npi-01/139 dt.25.06.2026.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe Zyrës për Informim.

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SHTIMES-OPŠTINA ŠTIMLJE
v.v.
SHTIME-ŠTIMLJE

Kryesuesi i Kuvendit
Rrahman Jakupi